EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8429
E mërkurë, 11 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Aleanca propozon pension proporcional për qytetarët që kanë paguar kontribute, por nuk i plotësojnë 15 vjet stazh pune FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MEHMET BALLAZHI

NUK JAM I KËNAQUR ME MBËSHTETJEN E QEVERISË KURTI

- Mbështetja e qeverisë, për shkak të kapaciteteve buxhetore që ka në dispozicion, është e domosdoshme për komunën e Hanit të Elezit



Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi, ka thënë se nuk është aspak i kënaqur me mbështetjen e qeverisë Kurti. Ai ka thënë se kjo komunë ka nevojë për mbështetje konkrete nga qeveria, pasi buxheti vetjak është i pamjaftueshëm për realizimin e projekteve. Pavarësisht prej kësaj, Ballazhi ka bërë me dije se për vitin e ardhshëm kanë planifikuar realizimin e disa projekteve kapitale. Në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re", Ballazhi, i cili është edhe kryetar i Degës së PDK-së në Han të Elezit, ka folur edhe për zhvillimet brenda partisë dhe për vendimin e Gjykatës Speciale për liderët e UÇK-së. Për PDK-në, Ballazhi ka thënë se pret që nga procesi zgjedhor të dalë më e fortë dhe më e bashkuar, ndërsa vendimin e Speciales e ka quajtur të tmerrshëm. Në këtë kontekst, Ballazhi ka thënë se ka munguar mbështetja e institucioneve të Kosovës për mbrojtjen e liderëve të UÇK-së dhe të luftës çlirimtare

KURTI TAKOHET ME PERSONALITETE TË FRANCËS QË KONTRIBUUAN PËR KOSOVËN F. 3



NDOTJA E AJRIT NË KOSOVË: AVOKATI I POPULLIT PUBLIKON RAPORTIN DHE KËRKON VEPRIME NGA INSTITUCIONET F. 7



AKTUALE



SHBA-ja SHPRESON PËR PAQE NË UKRAINË TEKSA ZHVILLOHEN BISEDIMET NË ABU DABI F. 2

KDI: LLOGARIDHËNIA PUBLIKE DUHET TË BËHET STANDARD, JO TË PENGOHET NGA DEPUTETËT F. 6

15 VJET NË KËRKIM TË DREJTËSISË PËR DIANA KASTRATIN, FAMILJA KËRKON EPILOGUN E MERITUAR TË RASTIT F. 7

EKONOMI



BQK-ja PARAQET PARA STUDENTËVE TË UP-SË REFORMAT NË SISTEMIN E PAGESAVE: SEPA DHE TIPS CLONE F. 8

HOTI: BUXHETI NUK MATET ME SHIFRAT NË LETËR, POR ME CILËSINË E JETËS SË QYTETARËVE F. 8

SPORT



XHAKA, LOJTARI MË I MIRË ME NUMRIN 34 NË FANELLË F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja SHPRESON PËR PAQE NË UKRAINË TEKSA ZHVILLOHEN BISEDIMET NË ABU DABI

UASHINGTON, 10 NËNTOR - Shtetet e Bashkuara shpresojnë se bisedimet në mes të Uashingtonit, Kievit dhe Moskës, që nisën mëngjesin e 10 nëntorit në Abu Dabi, mund të sjellin përparim të rëndësishëm drejt përfundimit të luftës së Rusisë në Ukrainë.

Zyrtarë të lartë amerikanë u thanë gazetarëve se ka shenja të një gatishmërie në rritje nga të dyja palët për të arritur marrëveshje. Megjithatë, optimizmi amerikan bie ndesh me skepticizmin e zyrtarëve evropianë dhe analistëve të Rusisë, të cilët thonë se ka pak dëshmi që Moska është e gatshme të bëjë lëshime lidhur me territoret apo sigurinë e ardhshme të Ukrainës.

Sipas zyrtarëve amerikanë, të cilët folën në kushte anonimiteti, presidenti amerikan Donald Trump mbetet i përkushtuar për t'i dhënë fund luftës dhe i ka udhëzuar përfaqësuesit e tij të synojnë një paqe të qëndrueshme në vend të një marrëveshjeje të shpejtë, por të brishtë.

Bisedimet me përfaqësuesit rusë dhe ukrainas janë shtuar muajt e fundit, thanë zyrtarët amerikanë. Sipas tyre, kontaktet tani zhvillohen çdo ditë, ndonjëherë edhe disa herë brenda ditës. "Tani kemi një mundësi për të bërë përparim të rëndësishëm drejt përfundimit të luftës", tha një nga zyrtarët.

Takimet në Abu Dabi synojnë t'i qartësojnë qëndrimet e Rusisë dhe Ukrainës dhe t'i identifikojnë çështjet për të cilat palët vazhdojnë të kenë mospajtime.

Zyrtarët amerikanë, megjithatë, paralajmëruan se nuk presin që gjatë këtyre bisedimeve dyditore të arrihet ndonjë marrëveshje përfundimtare.

Kryenegociatori ukrainas Rustem Umerov tha se synimi përfundimtar i bisedimeve duhet të jetë arritja e një paqeje të qëndrueshme.

Homologu i tij rus, Vladimir Medinsky, tha se Moska beson se përfundimi i luftës do të ishte në interes të të dyja vendeve.

Synimi për një paqe të qëndrueshme

Zyrtarët amerikanë thanë se sfida kryesore është të binden Rusia dhe Ukraina se armëpushimi nuk do t'i shërbejë palës tjetër për t'u riarmatosur dhe për t'u përgatitur për një konflikt të ri. Sipas tyre, Uashingtoni po shqyrton masa për të parandaluar një skenar të tillë, përfshirë konsultimet për sigurinë, komunikimin në raste krizash, shkëmbimin e informacioneve për aktivitetet ushtarake dhe hapa të ndërsjellë për uljen e tensioneve. "Përveç përqendrimit kryesor në arritjen e një paqeje të qëndrueshme, diskutimet përfshinë edhe mënyrat se si mund të shfrytëzohen dhe forcohen institucionet dhe marrëveshjet ekzistuese të sigurisë evropiane, pas përfundimit të luftës në Ukrainë", shkroi i dërguari amerikan, Steve Witkoff, në platformën X.

Ai e bëri këtë deklaratë pas takimit të zyrtarëve amerikanë, ukrainas dhe evropianë më 10 nëntor, përpara bisedimeve të planifikuara me Rusinë dhe Ukrainën.

Zyrtarët amerikanë thanë se synimi është krijimi i një kuadri më të gjerë të sigurisë pas luftës, që do të merrte parasysh shqetësimet e Rusisë, Ukrainës dhe vendeve evropiane, duke respektuar njëkohësisht sovranitetin dhe të drejtën e secilit shtet për të marrë vendime të pavarura.

Ata theksuan se NATO-ja do të vazhdonte ta kishte rolin qendror në mbrojtjen kolektive të Evropës.

Zyrtarët amerikanë thanë se Uashingtoni i ka kërkuar Moskës të pranojë garanci të sigurisë për Ukrainën, të ngjashme me ato që parashihen në nenet 4 dhe 5 të Traktatit të NATO-s.

Këto nene parashohin konsultime mes aleatëve kur njëri prej tyre ndihet i kërcënuar dhe mbrojtje kolektive në rast të një sulmi të armatosur.

Sipas një zyrtari amerikan, çdo garanci sigurie nga ShBA-ja do të varej përfundimisht nga presidenti Donald Trump dhe presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky.

Megjithatë, Trumpi dëshiron që vendet evropiane të mbulojnë barrën financiare të sigurisë së Ukrainës.

Një tjetër çështje e rëndësishme në bisedime do të jetë territori, veçanërisht e ardhmja e rajonit lindor të Donjeckut, për të cilin Rusia pretendon se i përket asaj, por nuk e kontrollon plotësisht.

Rusia vazhdon të kërkojë kontrollin mbi të gjithë rajonin e Donjeckut, ndërsa Ukraina këmbëngul që çdo marrëveshje të bazohet në vijën aktuale të frontit.

Por, sipas zyrtarëve amerikanë, të dyja palët kanë treguar në bisedime jopublike njëfarë gatishmërie për kompromis, ndonëse nuk kanë dhënë më shumë hollësi.

Presidenti ukrainas, Zelensky, ka refuzuar të heqë dorë nga territoret që vazhdojnë të kontrollohen nga forcat ukrainase, përfshirë një pjesë të Donjeckut.

Humbja e këtij territori mund ta bënte Ukrainën më të cenueshme ndaj sulmeve të ardhshme ruse.

Zyrtarët amerikanë theksuan se çështjet territoriale dhe garancitë e sigurisë për Ukrainën pas luftës, duhet të negociohen njëkohësisht dhe të përfshihen në një marrëveshje të përbashkët përfundimtare.

Në takimet në Abu Dabi marrin pjesë edhe përfaqësues të vendeve evropiane, pasi Uashingtoni synon t'i zgjerojë bisedimet përtej formatit trepalësh mes SHBA-së, Ukrainës dhe Rusisë.



Pjesëmarrja e vendeve evropiane

Në bisedime janë duke marrë pjesë edhe Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe - të njohura si grupi E3 - si dhe Italia, NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe Ukraina. Megjithatë, konsultimet e tyre fillestare me përfaqësuesit amerikanë do të zhvillohen ndaras nga negociatat trepalëshe me Rusinë.

Përfaqësuesit evropianë pritet të diskutojnë për garancitë e sigurisë dhe mënyrën se si do të organizohet siguria në Evropë dhe marrëdhëniet me Rusinë, pas përfundimit të luftës.

Propozimi më i gjerë ka ngritur shqetësime në kryeqytetet evropiane se Moska mund të fitojë ndikim mbi mënyrën se si organizohet siguria e kontinentit. Kjo mund të dobësojë rolin e NATO-s dhe të cenojë sovranitetin e vendeve që dikur ishin nën dominimin sovjetik. "Ne tashmë kemi një arkitekturë evropiane të sigurisë", tha më 6 nëntor shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, duke theksuar se Bashkimi Evropian duhet të jetë pjesë e çdo marrëveshjeje.

Por, Rusia vazhdon të ketë mosbesim të thellë ndaj qeverive evropiane, të cilat i fajëson për dështimin e një marrëveshjeje të mëhershme të negociuar në Stamboll, thanë zyrtarët amerikanë.

Bisedimet e vitit 2022 nuk kishin rezultuar me një marrëveshje përfundimtare, pasi palët vazhdonin të kishin mospajtime të mëdha për sigurinë dhe sovranitetin e Ukrainës.

Zyrtarët amerikanë thanë se Uashingtoni ia ka bërë të qartë Moskës se vazhdon të bashkëpunojë ngushtë me Bashkimin Evropian, NATO-n dhe aleatët e tij evropianë. Sipas tyre, përfshirja e Evropës do ta ndihmonte arritjen e një marrëveshjeje, në vend që ta pengonte atë. "Për t'i dhënë fund luftës, na duhet patjetër Evropa në tryezën e negociatave", tha njëri nga zyrtarët. Po sipas tyre, bashkëpunimi me Ukrainën dhe qeveritë evropiane është intensifikuar gjatë gjashtë javëve të fundit, përfshirë diskutimet në Bruksel për sigurinë e Ukrainës pas luftës dhe rimëkëmbjen e saj ekonomike.

Zyrtarët e përshkruan këtë bashkëpunim si të ngushtë dhe konstruktiv, duke hedhur poshtë pretendimet se po thellohen përçarjet mes Uashingtonit dhe aleatëve evropianë.

Paralelisht, një grup tjetër pune, në të cilin rol udhëheqës ka edhe Banka Botërore, po shqyrton reformat që do t'i nevojiten Ukrainës për të ndërtuar një ekonomi të qëndrueshme pas luftës.

Diskutimet përfshijnë nevojat ushtarake dhe financiare të vendit, rindërtimin ekonomik dhe problemet e vazhdueshme me korrupsionin.

Të pyetur nëse Rusia po tregon gatishmëri për kompromis, zyrtarët amerikanë thanë se Moska ka dhënë sinjale pozitive se dëshiron t'i japë fund luftës, veçanërisht gjatë diskutimeve për mënyrën se si do të organizohet siguria pas konfliktit.

Megjithatë, analistët paralajmërojnë se Moska mund të jetë duke i shfrytëzuar negociatat për të fituar kohë, ndërsa vazhdon të kërkojë territore të Ukrainës dhe të ushtrojë presion ushtarak ndaj këtij vendi. "Për Perëndimin, negociatat janë një mjet për t'i dhënë fund luftës; për Putinin, ato mund të jenë një mjet për ta fituar atë", shkroi më 8 nëntor në platformën X Sam Greene, profesor në Institutin për Rusinë në Kolegjin Mbretëror të Londrës.

Skeptike u shpreh edhe shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, e cila, më 9 nëntor, tha se Rusia vetëm "po shtiret sikur po negocion" dhe se nuk ka treguar vullnet të mirë.

Zyrtarët amerikanë iu referuan edhe bisedimeve të mëhershme me presidentin rus, Vladimir Putin, në Shën Petersburg, ku ishte diskutuar mundësia e krijimit të një sistemi të përbashkët rregullash dhe mekanizmash të sigurisë mes Rusisë dhe Perëndimit. "Kjo është hera e parë që kam përshtypjen se pala ruse ka vërtet dëshirë t'i japë fund luftës", tha njëri nga zyrtarët amerikanë.

Sidoqoftë, Moska vazhdon të refuzojë një armëpushim pa kushte dhe këmbëngul që Ukraina të heqë dorë nga pjesët e rajonit të Donjeckut që ende i kontrollon.

Delegacioni rus në Abu Dabi udhëhiqet nga Vladimir Medinsky, këshilltar i Kremlinit, i cili ka udhëhequr edhe disa runde të mëhershme negociatash, përfshirë bisedimet në Gjenevë, në shkurt.

Gjatë atyre takimeve, ai kryesisht ka përsëritur kërkesat e Moskës, pa treguar shumë gatishmëri për kompromis.

Marrëveshja e mundshme mund të përfshijë edhe lehtësimin e sanksioneve ndaj Rusisë, si një mënyrë për ta nxitur Moskën t'i përmbahet asaj.

Sipas një zyrtari amerikan, sanksionet mund të hiqen gradualisht, por të rikthehen nëse Rusia shkel marrëveshjen.

Zyrtarët amerikanë thanë se synojnë përparim të shpejtë në negociata, për shkak të numrit në rritje të viktimave civile dhe ushtarake.

Por, paralajmëruan se arritja e një marrëveshjeje të qëndrueshme do të kërkojë kompromise të vështira. Sipas tyre, takime të tjera me presidentin rus, Vladimir Putin, dhe atë ukrainas, Volodymyr Zelensky, mund të zhvillohen së shpejti, varësisht nga rezultati i bisedimeve në Abu Dabi.

Zyrtarët përmendën edhe përpjekjet humanitare, përfshirë një armëpushim të fundit gjashtëditor në Oleshki, në rajonin ukrainas të Hersonit, i cili, sipas tyre, mundësoi evakuimin e civilëve dhe dërgimin e ndihmave humanitare. Ata thanë se Uashingtoni do të vazhdojë të punojë edhe për shkëmbimin e të burgosurve dhe çështje të tjera humanitare.

Përpjekjet diplomatike po zhvillohen në kohën kur gjendja e civilëve në Ukrainë po përkeqësohet.

Sulmet ruse ndaj infrastrukturës energjetike rrezikojnë t'i lënë miliona njerëz pa energji elektrike dhe ujë për periudha të gjata, ndërsa po afrohet dimri.

Në një mbledhje të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, më 9 nëntor, zyrtarët e çështjeve humanitare paralajmëruan për përkeqësimin e kushteve të jetesës.

Ndihmëssekretari i përgjithshëm i OKB-së për Çështje Humanitare, Mohamed Yahya, tha se ndihma emergjente "nuk mund ta zëvendësojë një rrjet elektrik që shkatërrohet vazhdimisht nga sulmet".

Për Uashingtonin, synimi i menjëhershëm i bisedimeve në Abu Dabi është që kontaktet diplomatike, të cilat janë intensifikuar kohët e fundit, të shndërrohen në një proces të mirëfilltë negociatash.

Ky proces duhet të trajtojë mosmarrëveshjet territoriale dhe të krijojë kushtet për një paqe të qëndrueshme. "Po përpiqemi t'ua shpjegojmë palëve të gjitha arsyet pse paqja është zgjidhja më e mirë, t'i bëjmë ato konkrete, t'i bindim se është e mundur dhe pastaj t'i ndihmojmë të gjejnë rrugën drejt saj", tha njëri nga zyrtarët amerikanë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KURTI TAKOHET ME PERSONALITETE TË FRANCËS QË KONTRIBUUAN PËR KOSOVËN

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PARIS, 10 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, para nisjes zyrtare të Forumit të Paqes në Paris, ka takuar personalitete të Francës, që në forma të ndryshme janë të lidhur ose kanë kontribuuar për vendin tonë.

Pjesë e takimit ishin Alain Richard, ish-ministër i Mbrojtjes dhe mbështetës i ndërhyrjes së NATO-s për t'i ndalur krimet e luftës dhe spastrimin etnik ndaj shqiptarëve të Kosovës nga aparati shtetëror i Serbisë më 1999; Gilles Pernet, oficer i ushtrisë dhe ish-administrator i lartë në Departamentin e Çështjeve Strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes, bashkautor i librit "Kosovo: récits sur la construction d'un État", me Sébastien Gricourt, përkrahësin e Republikës së Kosovës; Véronique Nahoum-Grappe, antropologe dhe studiuese, kërkimet e së cilës janë të përqendruara te dhuna seksuale në luftëra e konflikte, e cila ka qenë e angazhuar për Kosovën që nga vitet e '90 dhe është autore e librit "Kosovo: un drame annoncé". Ajo është e bija e filozofit dhe sociologut të famshëm Edgar Morin; Frédérique Duversin, drejtoreshë e Qendrës Kulturore të Kosovës në Paris, përkrahëse e popullit dhe shtetit tonë që nga dekada e fundit e shekullit të kaluar, sikurse promovuese e kulturës e mbështetëse e studentëve e artistëve tanë dhe artit e kulturës sonë; Florence Hartmann, gazetare dhe ish-korrespondente e Le Monde, njohëse e drejtësisë ndërkombëtare dhe e Ballkanit Perëndimor, këshilltare dhe zëdhënëse e ish-kryeprokurores së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY) në Hagë, autore e disa librave, përfshirë atë "Milosevic, la diagonale du fou". "Biseduam për përparimin demokratik dhe zhvillimin e qëndrueshëm e të vazhdueshëm ekonomik, për investimet në siguri e në mbrojtje, për aktgjykimin e padrejtë të 16 shtatorit dhe angazhimin për korrigjimin e tij në apel", tha kryeministri Kurti.

Po ashtu, kryeministri Kurti foli edhe për planet në mandatin e ri qeverisës dhe për rolin e rëndësishëm të Francës në rrugën e Republikës së Kosovës drejt integrimit euroatlantik.

Kurti u prit në takim nga presidenti i Senatit të Francës, Larcher

Kurti është pritur në Paris nga presidenti i Senatit të Francës, Gerard Larcher.

Kryeministri i ka shprehur mirënjohjen Larcherit për rolin e Republikës së Francës për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës si dhe mbështetjen e vazhdueshme për zhvillimin e Republikës sonë. "Biseduam për stabilitetin e plotë institucional e politik pas zgjedhjes së presidentes, planet e Qeverisë në këtë mandat të ri, të përqendruara në infrastrukturën hekurudhore e atë sportive, ndërtimin e digave dhe industrinë e mbrojtjes, por edhe mundësitë konkrete të zgjerimit të bashkëpunimit dhe thellimit të mëtejmë të marrëdhënieve dypalëshe", tha kryeministri Kurti.



Krahas angazhimit për reforma posaçërisht në drejtësi, arsim e administratë publike, kryeministri Kurti dhe Larcher folën edhe për përparimin demokratik dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Kryeministri Kurti tha se "Republika e Kosovës është tërësisht e linjëzuar me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, andaj statusi i vendit kandidat dhe hapja e negociatave për anëtarësim, përveçqë vendime të drejta, do të ishin shtysë për përparim të gjithmbarshëm".

Kryeministri Kurti shtoi se roli mbështetës i Francës për avancimin e Republikës sonë në këtë proces është i rëndësishëm, sikurse në atë të anëtarësimit në NATO, që do t'i kontribuonte paqes së qëndrueshme dhe sigurisë afatgjate të Ballkanit Perëndimor dhe mbarë Evropës.

Po ashtu, kryeministri Kurti ka mbajtur fjalim dhe ka diskutuar me studentë të Paris School of International Affairs.

Kurti takohet me kryetarin e Parisit, diskutojnë për bashkëpunimin në fushën e banimit dhe kulturës

Kryeministri Kurti pas pjesëmarrjes në panelin "Making Peace Last: Rebuilding Societies After War", në Forumin e Paqes, është takuar me kryetarin e Parisit, Emmanuel Grégoire.

Kryeministri Kurti e ka falënderuar kryetarin Grégoire për pritjen dhe i ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen e Francës për Republikën e Kosovës. "Me kryetarin Grégoire, i cili është një nga anëtarët e aleancës evropiane të kryetarëve të bashkive për banim (Mayors for Housing Alliance), biseduam për përvojat dhe mundësitë e ndërveprimit konkret. E njoftova për programin tonë të Banimit të Përballueshëm dhe Social që po zhvillohet, avancon dhe do të zgjerohet, sikurse për projektin e Banimit Social Adekuat, që do të shtrihet në 21 komuna gjithandej vendit", tha kryeministri Kurti.

Më tutje Kurti ka shtuar se "jemi të interesuar që t'i forcojmë lidhjet me Parisin nëpërmjet bashkëpunimit praktik që i shërben qytetarëve tanë dhe që bashkon komunitetin kulturor, duke mirëpritur ekspozita, filma, ngjarje letrare e artistë nga kryeqyteti francez. Mërgata dhe profesionistët tanë kulturorë mund të jenë lehtësues të këtyre shkëmbimeve".





Fotografia zyrtare e presidentes Shiroka-Pula është vendosur në Presidencë dhe në institucionet e Republikës së Kosovës

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Në përputhje me Rregulloren nr. 19/2011 për kriteret e përzgjedhjes dhe vendosjes së fotografisë së presidentit/es të Republikës së Kosovës dhe brenda afateve të përcaktuara, Departamenti i Protokollit të Shtetit ka bërë shpërndarjen e fotografisë zyrtare të presidentes së Republikës së Kosovës, Sh. S. Justina Shiroka-Pula në institucionet qendrore dhe lokale, agjencitë dhe institucionet e tjera përkatëse, si dhe në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës në mbarë botën.

Fotografia zyrtare e presidentes është realizuar nga mjeshtri i fotografisë, Arben Llapashtica.





FLET PËR "EPOKËN E RE", MEHMET BALLAZHI

NUK JAM I KËNAQUR ME MBËSHTETJEN E QEVERISË KURTI

- Mbështetja e qeverisë, për shkak të kapaciteteve buxhetore që ka në dispozicion, është e domosdoshme për komunën e Hanit të Elezit

Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi, ka thënë se nuk është aspak i kënaqur me mbështetjen e qeverisë Kurti. Ai ka thënë se kjo komunë ka nevojë për mbështetje konkrete nga qeveria, pasi buxheti vetjak është i pamjaftueshëm për realizimin e projekteve. Pavarësisht prej kësaj, Ballazhi ka bërë me dije se për vitin e ardhshëm kanë planifikuar realizimin e disa projekteve kapitale. Në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re", Ballazhi, i cili është edhe kryetar i Degës së PDK-së në Han të Elezit, ka folur edhe për zhvillimet brenda partisë dhe për vendimin e Gjykatës Speciale për liderët e UÇK-së. Për PDK-në, Ballazhi ka thënë se pret që nga procesi zgjedhor të dalë më e fortë dhe më e bashkuar, ndërsa vendimin e Speciales e ka quajtur të tmerrshëm. Në këtë kontekst, Ballazhi ka thënë se ka munguar mbështetja e institucioneve të Kosovës për mbrojtjen e liderëve të UÇK-së dhe të luftës çlirimtare

EPOKA E RE Lirim GECI

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi, ka thënë se nuk është aspak i kënaqur me mbështetjen e qeverisë Kurti. Ballazhi në këtë intervistë për "Epokën e re", ka thënë se Hani i Elezit ka nevojë për mbështetje konkrete nga qeveria, pasi buxheti i komunës është i pamjaftueshëm për realizimin e projekteve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. "Kërkesat i kemi të shumta dhe të fushave të ndryshme, si të ambientit, infrastrukturës, shkollave etj. por, megjithatë, shumë pak kemi investime nga qeveria. Me buxhetin që kemi jemi duke i kryer punët tona, por mbështetja e qeverisë, për shkak të kapaciteteve buxhetore që ka në dispozicion, është e domosdoshme për komunën e Hanit të Elezit", ka thënë Ballazhi.

Pavarësisht prej kësaj, Ballazhi ka bërë me dije se për vitin e ardhshëm kanë planifikuar realizimin e disa projekteve kapitale. "Për vitin 2027 është planifikuar ndërtimi i çerdhes që si komunë shpresojmë shumë ta përfundojmë me grand qeveritar. Përpos çerdhes kemi planifikuar ndërtimin e sheshit të qytetit. Gjithashtu është projekti i muzeut të qytetit, ku duhet të përfundojë faza e dytë, por për shkak të procedurave, nuk ka përfunduar këtë vit. Pastaj është projekti 'Bllaca '99', i cili është në faza të ndryshme. Për vitin e ardhshëm kemi planifikuar investime në infrastrukturën rrugore, sidomos në ato lokalitete ku është e nevojshme të intervenohet. Krahas kësaj kemi planifikuar ndërrimin e gypave kryesorë të ujësjellësit, pra rehabilitimin e rrjetit", është shprehur Ballazhi.

Më tutje, Ballazhi ka thënë se ka bashkëpunim korrekt me të gjitha partitë politike që janë të përfaqësuara në Kuvendin Komunal të Hanit të Elezit.

Në këtë intervistë, Ballazhi, i cili është edhe kryetar i Degës së PDK-së në Han të Elezit, ka folur edhe për zhvillimet brenda PDK-së dhe vendimin e Gjykatës Speciale për liderët e UÇK-së. Për PDK-në, Ballazhi ka thënë se pret që nga procesi zgjedhor të dalë më e fortë dhe më unike. "Ne jemi duke punuar që t'i tejkalojmë vështirësitë që kemi dhe tani të shoshim se si do të ecim tutje pas zgjedhjeve që do të mbahen brenda partisë. Nga procesi zgjedhor pres të ketë rifreskim dhe forcim të partisë. Megjithatë, duhet të ketë angazhim maksimal që PDK-ja të dalë sa më e fuqishme dhe konkurruese nga zgjedhjet", është shprehur Ballazhi.

Ndërsa sa i përket procesit gjyqësor në Hagë, Ballazhi ka thënë se vendimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka qenë i tmerrshëm. "Vendimi ka qenë i tmerrshëm. Ta them të drejtën kam pasur një besim te drejtësia ndërkombëtare, megjithatë nuk doli ashtu si prisja jo vetëm unë, por të gjithë qytetarët. Pavarësisht kësaj, besoj se në fazën e apelit të hidhet poshtë vendimi i tmerrshëm i shkallës së parë i Gjykatës Speciale", është shprehur Ballazhi. Duke e përmbledhur procesin e deritashëm në Hagë, Ballazhi ka thënë se ka munguar mbështetja e institucioneve të Kosovës. "Shteti do të duhej të ishte i angazhuar maksimalisht edhe për demaskimin e dëshmive të rreme që janë deponuar në Hagë. Unë nuk jam i kënaqur me angazhimin e shtetit. Fare nuk ka pasur angazhim të bartësve të institucioneve për ta mbrojtur luftën çlirimtare. Duke i mbrojtur ata burra do të mbrohej shteti i Kosovës dhe pastërtia e luftës për liri dhe pavarësi", ka deklaruar Ballazhi.

"Epoka e re": *Z. Ballazhi, si është duke funksionuar sot komuna e Hanit të Elezit?*

Ballazhi: Natyrisht sikurse të gjitha komuna e tjera edhe ne i kemi projektet e planifikuara me buxhetin ashtu siç e parasheh ligji.

→

Në këtë drejtim, çdo buxhet i vitit vijues miratohet një vit më herët për të pasur mundësi që të bëhen planifikimet e duhura për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me komunën. Prandaj në këtë drejtim parashohim projektet që janë të mundshme për t'u realizuar. Kemi shumë projekte të cilat nuk mund t'i implementojmë për shkak të kufizimeve buxhetore. Natyrisht të gjitha projektet që planifikohen në buxhet realizohen. Projektet që planifikohen realizohen nga buxheti i komunës, por në disa raste edhe nga grantet qeveritare dhe donatorët e ndryshëm. Kur jemi tek investimet, komuna e Hanit të Elezit ka nevojë për investime të shumta, por për shkak të buxhetit të limituar jemi të kufizuar. Vullneti, gatishmëria dhe projektet ekzistojnë, por jemi të penalizuar nga mungesa e buxhetit.

"Epoka e re": *Në bazë të buxhetit që kemi në dispozicion, cilat janë projektet kryesore që keni planifikuar t'i kryeni për vitin e ardhshëm?*
Ballazhi: Për vitin 2027 është planifikuar ndërtimi i çerdhes që shpresojmë shumë ta përfundojmë me grand qeveritar. Përpos çerdhes, kemi planifikuar ndërtimin e sheshit të qytetit. Gjithashtu është projekti i muzeut të qytetit. Fillimisht duhet të përfundojë faza e dytë, por për shkak të procedurave nuk ka përfunduar këtë vit. Pastaj është projekti "Bllaca '99", i cili është në faza të ndryshme. Për vitin e ardhshëm kemi planifikuar investime në infrastrukturën rrugore, sidomos në ato lokalitete ku është e nevojshme të intervenohet. Krahas kësaj, kemi planifikuar ndërrimin e gypave kryesorë të ujësjellësit, pra rehabilitimin e rrjetit.

Hani i Elezit ka nevojë për mbështetjen e qeverisë

"Epoka e re": *Z. Ballazhi, sa jeni i kënaqur me bashkëpunimin ose përkrahjen që keni nga qeveria?*
Ballazhi: Nuk jam i kënaqur me mbështetjen që na jap qeveria, pasi kemi nevojë dhe jo dëshira për përkrahje serioze financiare. Nevojat janë të mëdha, por mbështetja nuk është e duhur. Kemi realizuar projekte të ndryshme, por me shumë vështirësi.

"Epoka e re": *A keni bërë ndonjë kërkesë në nivelin qendror që të keni mbështetje për projekte të caktuara?*
Ballazhi: Kërkesat i kemi të shumta dhe të fushave të ndryshme, të ambientit, infrastrukturës, shkollave etj. por, megjithatë, shumë pak kemi investime nga qeveria. Me buxhetin që kemi jemi duke i kryer punët tona, por mbështetja e qeverisë, për shkak të kapaciteteve buxhetore që ka në dispozicion, është e domosdoshme për komunën e Hanit të Elezit. Prandaj në këtë drejtim kemi vështirësi në bashkëpunimin dhe mbështetjen e qeverisë, sepse Hani i Elezit është komunë e cila është në kufirin me Maqedoninë e Veriut dhe, natyrisht, meriton më shumë investime për transformim rrënjësor.

"Epoka e re": *Cili është bashkëpunimi juaj me opozitën në Hanin e Elezit?*
Ballazhi: Hani i Elezit përfaqësohet në Kuvendin Komunal me katër parti politike. Me shumicën prej tyre jemi në bashkëpunim dhe nuk kemi ndonjë dallim politik sa i përket së ardhmes së komunës. Bashkëpunimi është korrekt. Natyrisht që kemi zëra kritikë edhe brenda partisë që drejtoj, por këtë e shoh si vlerë. Në Kuvendin Komunal asnjëherë nuk kemi pasuar pengesa që t'i shtyjmë projektet përpara. Në këtë drejtim, unë kam komunikim të përditshëm jo vetëm me përfaqësuesit e partive politike, por edhe me qytetarët të cilët i falënderoj për bashkëpunim dhe mirëkuptimin që tregojnë.

Nga procesi zgjedhor në PDK pres rifreskim dhe forcim të partisë

"Epoka e re": *Z. Ballazhi, si jeni duke e parë funksionimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në nivel vendi, pasi ju jeni edhe kryetar i Degës së PDK-së në Han të Elezit dhe anëtar i Këshillit Drejtues?*
Ballazhi: Jemi në një fazë jo aq të mirë të funksionimit si parti, sepse na mungojnë udhëheqësit kryesorë të cilët kanë qenë edhe drejtues të luftës çlirimtare. Ne jemi duke punuar që t'i tejkalojmë vështirësitë që kemi. Të shoshim se si do të ecim tutje pas zgjedhjeve që do të mbahen brenda partisë. Nga procesi zgjedhor pres të ketë rifreskim dhe forcim të partisë. Megjithatë duhet të ketë angazhim maksimal që PDK-ja të dalë sa më e fuqishme dhe konkurruese nga zgjedhjet.

"Epoka e re": *Cilat janë pritjet tuaja nga procesi zgjedhor brenda PDK-së?*
Ballazhi: Besoj se do të dalim shumë më të bashkuar për shkak se në zgjedhjet e brendshme partiake gjithmonë ka rifreskime dhe energji të reja. Personalisht mendoj se nga ky proces do të dalim shumë më të fuqishëm



sesa jemi tani. I ftoj sidomos të rinjtë dhe të rejat që t'i bashkohen vizionit të PDK-së për të ardhmen e Kosovës. Mendoj se PDK-ja është partia e vetme e cila mund ta bëjë dallimin në qeverisje. Ketë e ka dëshmuar në të kaluarën, edhe pse propaganda kundër nesh ka qenë e madhe. Tashmë qytetarët e kanë kuptuar se adresa për transformimin e Kosovës është PDK-ja.

Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së ishte i tmerrshëm

"Epoka e re": *Kryetar, gjatë luftës çlirimtare keni qenë komandant i UÇK-së. Si e keni parë vendimin e Gjykatës Speciale për bashkëluftëtarët tuaj, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, të cilët janë dënuar në shkallën e parë me 81 vjet burgim?*
Ballazhi: Vendimi ka qenë i tmerrshëm. Ta them të drejtën kam pasur një besim te drejtësia ndërkombëtare, por nuk doli ashtu si prisja jo vetëm unë, por të gjithë qytetarët. Pavarësisht prej kësaj, besoj se në fazën e apelit të hidhet poshtë vendimi i



tmerrshëm i shkallës së parë të Gjykatës Speciale. Është e palogjikshme dhe absurde që çlirimtarët tanë të krahasohen me kriminelët e Serbisë të cilët kanë kryer krime të tmerrshme ndaj shqiptarëve. Ata burra dhe UÇK-ja ka luftuar vetëm kundër tyre dhe regjimit të Sllobodan Millosheviqit. Ju e keni parë se si shteti serb organizoi ceremoni shtetërore për varrimin e një krimineli dhe, në anën tjetër, dënohen çlirimtarët tanë. Kjo është e paimagjinueshme dhe nuk do koment.

"Epoka e re": *Gjatë këtyre viteve të procesit gjyqësor në Hagë, si e keni parë angazhimin e institucioneve të Kosovës? Sa kanë qenë në nivel të detyrës?*
Ballazhi: Jo aq sa duhet. Ose më mirë të them nuk kanë qenë fare në nivel të detyrës për ta ndihmuar procesin në Hagë dhe krerët e UÇK-së. Shteti do të duhej të ishte i angazhuar maksimalisht edhe për demaskimin e dëshmive të rreme që janë deponuar në Hagë. Unë nuk jam i kënaqur me angazhimin e shtetit. Fare nuk ka pasur angazhim të bartësve të institucioneve për ta mbrojtur luftën çlirimtare. Duke i mbrojtur ata burra, do të mbrohej shteti i Kosovës dhe pastërtia e luftës për liri dhe pavarësi. Falë luftës së UÇK-së, Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Fatkeqësisht mund të them se veprimet e qeverisë kanë qenë të kundërta.

"Epoka e re": *Dyshoni se lidershipi aktual shtetëror është angazhuar kundër krerëve të UÇK-së?*
Ballazhi: Sipas saj që është raportuar në medie, shihet se ka pasur edhe deponime të dëshmive të rrejshme edhe nga bartës institucionalë. Ne i kemi dëgjuar edhe në Kuvend se si në të kaluarën janë etiketuar krerët e UÇK-së. Po ashtu, vetë njerëzit e pushtetit kanë pranuar që kanë deponuar dosje në Hagë. Dhe kjo të bën të dyshosh se angazhimi institucional nuk ka qenë në mbështetje të krerëve të UÇK-së, por më shumë kundër tyre.

"Epoka e re": *Sipas jush, pse është punuar kundër krerëve të UÇK-së?*
Ballazhi: Besoj se këtu kemi të bëjmë me një urrejtje të paarsyeshme kundër krerëve të UÇK-së. Po ashtu, kjo urrejtje ka të bëje edhe me faktin se ata dëshirojnë ta kenë një vend në histori pa asnjë meritë. Kjo mendoj se është arsyeja. Djemtë dhe vajzat e UÇK-së e kanë shkruar historinë e Kosovës me luftën dhe sakrificën e tyre sublime. Prandaj, historia nuk mund të rishkruhet as nga Gjykata Speciale dhe as nga dikush tjetër.

"Epoka e re": *Çfarë prisni në Apelin e Gjykatës Speciale në rastin e liderëve të UÇK-së, dhe si e keni parë themelimin e grupit punues për hartimin e strategjisë shtetërore për këtë çështje?*
Ballazhi: Unë jam i prirë të besoj në institucione dhe në angazhimin institucional. Pres që ky grup punues ta bëjë punën e vet në mënyrë profesionale, edhe pse me shumë vonesë. Edhe tani është duke u vonuar. Megjithatë, duke u bazuar në gjyqtarët të cilët janë caktuar në këtë çështje gjyqësore, nuk pres shumë nga Gjykata e Apelit. Kam dyshimet e mia. Pavarësisht prej skepticizmit dhe mosbesimit tim, nëse vlerësohen drejt argumentet e mbrojtjes, krerët e UÇK-së duhet të jenë të lirë dhe të kthehen në Kosovë. Në këtë aspekt, grupi punues duhet ta bëjë punën e tij, pa vonesa dhe në funksion të ofrimit të fakteve se krerët e UÇK-së kanë qenë dhe janë vetëm çlirimtarë.

"Epoka e re": *Si e keni parë tërheqjen e Ligjit për Specialen, i cili fillimisht ishte miratuar në Kuvendin e Kosovës me iniciativën e PDK-së, kishte shkuar për dekretim te presidentja, por është rikthyer përsëri në Kuvend me kërkesë të partisë së cilës i takoni?*
Ballazhi: Kjo temë është politizuar shumë për interesa të caktuara, por nuk është keq që është kthyer në Kuvend. Nuk duhet të jemi pesimistë për kthimin e një ligji në Kuvend. Më mirë të kthehet dhe të plotësohet nëse ka nevojë. Nuk dua të hyj në hollësi se si ka shkuar procesi, por duhet të plotësohet për evitimin e ndonjë mangësie. Vlerësoj se ka ekspertë juridikë të mjaftueshëm të cilët do ta përmbyllin në mënyrën më të mirë të mundshme.

ALEANCA PROPOZON PENSION PROPORCIONAL PËR QYTETARËT QË KANË PAGUAR KONTRIBUTE, POR NUK I PLOTËSOJNË 15 VJET STAZH PUNE

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Aleanca ka propozuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti përmes të cilit synon t'u mundësohet pensioni kontributpagues proporcionalë edhe qytetarëve që kanë paguar kontribute para 1 janarit 1999, por nuk e kanë plotësuar periudhën e nevojshme për të përfituar nga skemat ekzistuese.

Deputetja e Aleancës, Teuta Haxhiu, në një konferencë për medie ka paraqitur propozimin për shtimin e nenit të ri 8/B, i cili parasheh që pensioni të llogaritet në përpjesëtim me vitet, muajt dhe ditët për të cilat qytetarët kanë paguar kontribute.

Haxhiu tha se propozimi synon t'i adresojë rastet kur qytetarëve u mungojnë vetëm disa muaj apo ditë për ta plotësuar periudhën e kërkuar, duke theksuar se skemat ekzistuese dhe të drejtat e personave që tashmë përfitojnë nga to do të ruhen.

"Sot po prezantoj një propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ky propozim ka një qëllim të qartë: të përfitojnë pension kontributpagues edhe qytetarët që kanë paguar kontribute, por që nuk e kanë plotësuar periudhën e nevojshme për t'u përfshirë në skemat ekzistuese. Bëhet fjalë për njerëz që kanë punuar dhe kanë paguar kontribute para 1 janarit 1999. Për njerëz që kanë vite pune të dëshmuara, por që sot nuk kualifikohen për pension kontributpagues, për shkak se nuk e arrijnë periudhën e kërkuar. Dikujt i mungon një vit, dikujt disa muaj, e dikujt mund t'i mungojnë vetëm disa ditë. Pyetja që shtrojmë sot është e thjeshtë: A duhet që mungesa e disa muajve apo ditëve t'ia mohojë një qytetari mundësinë për të përfituar nga vitet për të cilat ka paguar kontribute? Konsideroj se duhet të gjejmë një zgjidhje të drejtë. Nëse një person nuk e plotëson periudhën e nevojshme për pension sipas kushteve aktuale, ai duhet të ketë mundësi të marrë një pension në përpjesëtim me kontributet që ka paguar", ka thënë Haxhiu.



Ajo sqaroi se propozimi nuk parasheh ndryshimin e kushteve për pensionin kontributpagues të moshës dhe pensionin parcial kontributpagues për personat e larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme. "Pikërisht këtë synon propozimi që po prezantoj sot. Dua të sqaroj që në fillim një çështje shumë të rëndësishme për pensionistët dhe familjet e tyre: me këtë propozim ruhen skemat ekzistuese dhe të drejtat e të gjithë atyre që përfitojnë sipas tyre. Së pari, ruhet pensioni kontributpagues i moshës, i rregulluar me nenin 8 të ligjit. Personat që i plotësojnë kushtet e kësaj skeme do të vazhdojnë të përfitojnë sipas rregullave ekzistuese", ka theksuar Haxhiu.

KPK-ja DHE KGJK-ja DISKUTOJNË PËR PËRFAQËSIMIN E KOMUNITETEVE JOSHUMICË NË SISTEMIN E DREJTËSISË

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë, sfidat në proceset e rekrutimit dhe mundësitë për integrim e avancim profesional në institucionet e drejtësisë ishin në fokus të konferencës "Sfidat dhe përgjegjësitë në përfaqësimin e komuniteteve joshumicë në Sistemin e Drejtësisë në Kosovë".

Konferenca u organizua nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë.

Në të morën pjesë kryesuesi i KPK-së, Arian Gashi, kryesuesi i KGjK-së, Rrustem Thaqi, anëtarë të të dy këshillave, prokurorë, gjyqtarë dhe përfaqësues të komuniteteve joshumicë nga administratat e të dy këshillave.

Në fjalën e tij, kryesuesi i KPK-së, Arian Gashi, theksoi se përfaqësimi i komuniteteve joshumicë nuk është vetëm



detyrim ligjor dhe kushtetues, por edhe një element i rëndësishëm për besueshmërinë institucionale, legjitimitetin dhe forcimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Ai ritheksoi përkushtimin e KPK-së për mundësi të barabarta në rekrutim, zhvillim dhe avancim profesional, duke theksuar se përfaqësimi nuk duhet të kufizohet vetëm në aspektin numerik, por të sigurojë edhe integrim të plotë dhe përfshirje aktive të komuniteteve joshumicë në përgjegjësitë institucionale.

Në këtë drejtim ai theksoi synimin e KPK-së për një sistem prokurorial gjithëpërfshirës, profesional dhe të barabartë, në të cilin çdo qytetar, pa dallim të përkatësisë komunitare, të ketë besim dhe të ndihet i përfaqësuar. Në këtë kontekst, Gashi bëri me dije se KPK-ja ka shpallur konkurs për 34 pozita për prokurorë të shtetit, prej të cilave 10 janë të rezervuara për komunitetin serb. Ai vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet KPK-së, KGjK-së dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë, duke theksuar se diskutimet e kësaj konference duhet të rezultojnë me rekomandime dhe hapa konkretë për përmirësimin e përfaqësimit dhe integrimit të komuniteteve jo shumicë.

Gjithashtu, theksoi rëndësinë e raportit për përfaqësimin e këtyre komuniteteve në sistemin e drejtësisë, i cili do të ofrojë një pasqyrë më të qartë të gjendjes aktuale dhe do të ndihmojë në identifikimin e fushave ku nevojiten veprime të mëtejshme institucionale.

Në konferencë mori pjesë edhe ambasadori dhe shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Gerard McGurk, i cili në fjalën e tij përshëndeti organizimin e kësaj konference dhe vlerësoi nismën e përbashkët të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për trajtimin e çështjeve që lidhen me përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në sistemin e drejtësisë.

Ndërkaq, anëtarja e KPK-së dhe kryesuesja e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Administrimin e Prokurorive, Arlinda Muqa, duke folur edhe nga perspektiva e saj si pjesëtare e komunitetit rom, theksoi se sfida kryesore nuk qëndron vetëm në garantimin ligjor të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë, por në zbatimin e këtyre garancive në praktikë. Ajo nënvizoi se përfaqësimi i mirëfilltë kërkon krijimin e mundësive të barabarta për qasje në arsimim, punësim, avancim profesional dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse. Sipas saj, përfaqësimi nuk duhet të trajtohet vetëm si çështje statistikore, por duhet të shoqërohet me përfshirje aktive, përgjegjësi institucionale dhe mundësi reale për zhvillim profesional.

KDI: LLOGARIDHËNIA PUBLIKE DUHET TË BËHET STANDARD, JO TË PENGOHET NGA DEPUTETËT

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shprehur shqetësimin për mosraportimin e vazhdueshëm të Autoritetit të Konkurrencës para Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi, Tregti dhe Inovacion, që po cenon ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj institucioneve publike. Sipas KDI-së, kjo çështje është edhe më shqetësuese duke pasur parasysh raportimet për mosfunksionimin e organit kolegjial të Autoritetit të Konkurrencës që nga prilli i vitit 2025, si dhe nevojën për sqarimin e pretendimeve lidhur me ligjshmërinë dhe funksionimin e këtij institucioni. "Çështja e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës u ngrit në mbledhjen e 20 tetorit 2026 të Komisionit, për çka edhe raportimi i kryetares së këtij institucioni Neime Binaku-Isufi u vendos në rend dite për një javë me vonë, më 27 tetor me miratimin e anëtarëve të Komisionit. Megjithatë, ajo me 23 tetor e njoftoi Komisionin se nuk mund të merrte pjesë dhe raportimi u shty. Komisioni tentoi të mblidhet një javë pas, më 3 nëntor, mirëpo mbledhja dështoi për mungesë kuorumi, kësaj radhe pasi të gjithë deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje munguan. Ndërkaq, një javë më vonë, në mbledhjen e 10 nëntorit, për të raportuar në Komision erdhën dy anëtare të Autoritetit, por jo edhe kryetarja. Për shkak të mospjesëmarrjes së kryeteres së Autoritetit në mbledhje, deputetët e VV-së propozuan largimin e kësaj pike nga rendi i ditës ose shtyrjen e saj, propozim që nuk mori mbështetjen e opozitës", thuhet në komunikatën e KDI-së.

KDI-ja vlerëson se mosraportimi i kryetares Binaku-Isufi para komisionit dhe veprimet e anëtarëve të LV-së për ta pamundësuar raportimin e institucioneve publike e cenojnë seriozisht llogaridhënien publike, për çka të gjithë deputetët e të gjitha forcave politike duhet të angazhohen maksimalisht.



"Deputetët janë aty për të kërkuar dhe garantuar llogaridhënie për të gjitha çështjet që prekin interesin publik.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 65, paragrafin 9, përcakton se Kuvendi mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike që, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit", theksohet në komunikatë.

KDI-ja u bënë thirrje deputetëve të Kuvendit që t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre institucionale dhe të mos lejojnë që interesat politike ta pengojnë mbikëqyrjen.

"Njëkohësisht, kërkon që Komisioni për Ekonomi ta rikthejë sa më parë në rend dite raportimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe të sigurojë trajtimin e çështjeve të ngritura. Mbikëqyrja parlamentare nuk është çështje e vullnetit politik të shumicës, por përgjegjësi kushtetuese e Kuvendit. Institucionet publike kanë detyrim të japin llogari, ndërsa Kuvendi ka përgjegjësi ta kërkojë dhe ta ushtrojë këtë mbikëqyrje", është theksuar në komunikatën e KDI-së.

15 VJET NË KËRKIM TË DREJTËSISË PËR DIANA KASTRATIN, FAMILJA KËRKON EPILOGUN E MERITUAR TË RASTIT



PRISHTINË, 10 NËNTOR - Pas ndërprerjes së seancës gjyqësore ndaj Adnon Jasharit, i akuzuar për vrasjen e Diana Kastratit, të martën para medieve janë deklaruar babai i viktimës, Gëzim Kastrati, dhe avokatja e familjes, Miranda Haxhiu.

Babai i Dianës, Gëzim Kastrati, shpreson se rasti do ta marrë epilogun e merituar, duke theksuar se familja tash e 15 vjet po përballet me dhimbjen dhe pritjen për drejtësi. Ai tha se këto vite kanë qenë të mbushura me vuajtje jo vetëm për familjen, por edhe për të gjithë ata që janë prekur nga kjo ngjarje, duke shprehur besimin se institucionet do ta çojnë deri në fund procesin gjyqësor. "Siç e tha edhe avokatja, ky është një rast që ka 15 vjet që drejtësia është vonuar. Por besojmë dhe shpresojmë që do ta marrë epilogun e merituar për gjithë këto vite vuajtje", ka thënë Kastrati. Ai foli për rastet e tjera të vrasjeve të grave që, sipas tij, vazhdojnë të mbeten pa një epilog përfundimtar, duke theksuar se nuk do të ndalet së ngrituri zërin për kërkimin e drejtësisë.

Kastrati u shpreh se ka kërkuar reagim institucional që nga viti 2011 dhe se pavarësisht prej vështirësive dhe pengesave të hasura ndër vite, do të vazhdojë të kërkojë drejtësi.

Ndërkaq, avokatja e familjes, Miranda Haxhiu, deklaroi se kërkesa e tyre do të mbetet që i pandehuri të përballet me drejtësinë dhe se do të përdorin të gjitha mjetet ligjore për të siguruar që drejtësia të vihet në vend. "Do të jetë një kërkesë e vazhdueshme që i pandehuri duhet të ballafaqohet me drejtësinë. Ne do të vazhdojmë me të gjitha mjetet tona ligjore të sigurohemi që kjo drejtësi të vihet në vend", ka deklaruar Haxhiu.

Seanca gjyqësore në rastin ndaj Adnon Jasharit, i akuzuar për vrasjen e ish-bashkëshortes së tij, Diana Kastrati është shtyrë për 23 dhjetor, në orën 09:00.

Shtyrja erdhi pas kërkesës së avokatit mbrojtës, Haxhi Millaku, i cili kërkoi kohë për t'u pajisur me shkresat e lëndës dhe për t'u njohur me dosjen e rastit. Sipas dokumenteve gjyqësore, Diana Kastrati kishte bashkëjetuar për më shumë se dhjetë vjet me të akuzuarin, me të cilin kishte një vajzë.

Në janar të vitit 2011 ajo kishte paraqitur padi për shkëputjen e bashkësisë jashtëmartesore dhe ishte zhvendosur bashkë me vajzën te prindërit e saj.

Më 26 prill, për shkak të kërcënimeve të pretenduara ndaj saj dhe vajzës, Kastrati kërkoi urdhër mbrojtjeje emergjente nga Gjykata Komunale në Prishtinë.

Gjykata kishte detyrimin të vendoste brenda 24 orëve, por nuk iu përgjigj kërkesës.

Më 18 maj Diana u vra me armë zjarri në Prishtinë.

Prindërit e saj, Gëzim dhe Makfire Kastrati, iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese, e cila në shkurt të vitit 2013 konstatoi se mosveprimi i gjykatës kishte shkelur të drejtën e Dianës për jetë dhe të drejtën për mjete juridike efektive.

Familja kërkoi më pas dëmshpërblim nga shteti.

Në vitin 2019 Gjykata Themelore në Prizren caktoi kompensim prej 95 mijë eurosh, por Gjykata e Apelit e uli shumën në 30 mijë euro në shkurt të vitit 2023. Sipas vendimit të Apelit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe qeveria u detyruan ta paguanin këtë shumë në mënyrë solidare.

Për vite me radhë një nga pengesat për zhvillimin e procesit gjyqësor ishte pamundësia e ekstradimit të të akuzuarit nga Spanja, shtet që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

Në vitin 2022 institucionet e Kosovës kishin konfirmuar se autoritetet spanjolle kishin refuzuar kërkesën për ekstradimin e tij. Megjithatë, mbetet e paqartë pse u deshën 15 vjet që të kërkohej gjykimi në mungesë dhe çfarë veprimesh ndërmorën institucionet gjatë kësaj periudhe.

NDOTJA E AJRIT NË KOSOVË: AVOKATI I POPULLIT PUBLIKON RAPORTIN DHE KËRKON VEPRIME NGA INSTITUCIONET

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**



PRISHTINË, 10 NËNTOR - Avokati i Popullit ka publikuar raportin për cilësinë e ajrit në Republikën e Kosovës nga perspektiva e të drejtave të njeriut, të cilin ua ka adresuar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të tjera përgjegjëse. Sipas komunikatës, raporti është hartuar në kuadër të hetimeve të iniciuara me vetiniciativë, bazuar në raportimet institucionale dhe mediale për ndotjen e ajrit në vend.

Qëllimi i tij, siç thuhet në njoftim, është vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit, i kornizës ligjore dhe institucionale, si dhe i efektivitetit të masave të ndërmarra nga autoritetet publike për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. "Nga shqyrtimi i të dhënave të institucioneve kompetente, Avokati i Popullit ka evidentuar se ndotja e ajrit vazhdon të përbëjë një ndër sfidat kryesore mjedisore dhe të shëndetit publik në Kosovë. Sipas të dhënave të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), gjatë vitit 2025 janë regjistruar 171 ditë me tejkalime të vlerës kufitare ditore të grimcave PM_{10} në rrjetin shtetëror të monitorimit, me përqendrim të ndotjes kryesisht gjatë sezonit dimëror", thuhet në komunikatë.

Ndërkaq, sipas komunikatës, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka vlerësuar se ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit lidhet me rritjen e rrezikut për sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare, veçanërisht te fëmijët, te moshuarit dhe personat me sëmundje kronike. "Raporti trajton gjithashtu sfidat në zbatimin e legjislacionit, mungesën e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për mbikëqyrjen inspektuese, nevojën për forcimin e monitorimit dhe koordinimit ndërinstitucional, si dhe rëndësinë e miratimit të politikave dhe masave të qëndrueshme për reduktimin e ndotjes.

Duke u mbështetur në standardet e zhvilluara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit ka theksuar se mbrojtja e të drejtave të njeriut nga pasojat e ndotjes mjedisore kërkon përmbushjen e detyrimeve pozitive të shtetit për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe efektive, veçanërisht kur autoritetet janë në dijeni për rreziqet që ndotja paraqet për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve", thuhet më tej në komunikatë.

Avokati i Popullit, sipas komunikatës, u ka adresuar institucioneve përgjegjëse rekomandime që synojnë forcimin e mekanizmave institucionalë, zbatimin efektiv të legjislacionit, avancimin e politikave publike dhe ndërmarrjen e masave të koordinuara e të qëndrueshme për reduktimin e ndotjes së ajrit. Këto rekomandime kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe garantimin e gëzimit efektiv të të drejtave të njeriut në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Ndalohet vendosja në treg e rreth 150 mijë lodrave për fëmijë me origjinë nga Kina


PRISHTINË, 10 NËNTOR - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT), në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, gjatë ditët e fundit ka realizuar një aksion të përbashkët inspektues në pikat doganore, me ç'rast ka ndaluar vendosjen në treg të rreth 150 000 lodrave për fëmijë, të gjitha me origjinë nga Kina.

Ky aksion është realizuar në kuadër të një aktiviteti të përbashkët të mbikëqyrjes së tregut në të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s, me qëllim të forcimit të kontrollit dhe parandalimit të hyrjes në treg të produkteve që nuk përmbushin standardet e sigurisë.

Gjatë kontrollit është konstatuar se lodrat e ndaluara nuk i plotësonin kërkesat themelore të përcaktuara me Rregulloren nr. 02/2017 për sigurinë e lodrave.

IQMT rikujton se lodrat për fëmijë, që nuk përmbushin kërkesat dhe standardet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi mund të paraqesin rrezik serioz për sigurinë dhe shëndetin e fëmijëve.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, përmes Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, do t'i vazhdojë aktivitetet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të produkteve që vendosen në treg, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe garantimit të sigurisë së produkteve.



Hoti: Buxheti nuk matet me shifrat në letër, por me cilësinë e jetës së qytetarëve

Prishtinë, 10 nëntor - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka kritikuar mënyrën se si po paraqitet suksesi ekonomik nga qeveria, duke thënë se buxheti nuk duhet të vlerësohet vetëm përmes shifrave miliardëshe, por mbi bazën e ndikimit që ka në jetën e përditshme të qytetarëve.

Përmes një postimi në "Facebook", Hoti ka theksuar se gjatë pesë viteve të fundit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), kostoja e jetesës është rritur mesatarisht për 45 për qind, ndërsa çmimet e shumë produkteve të konsumit familjar janë gati dyfishuar. Ai ka vlerësuar se kjo rritje e çmimeve e ka vështirësuar jetën e familjeve, duke shtuar se propaganda për sukses ekonomik nuk mund ta mbushë shportë. "Buxheti nuk matet me shifrat në letër, por me cilësinë e jetës së qytetarëve Në pesë vitet e fundit, sipas ASK-së, kostoja e jetesës është rritur mesatarisht për 45 %, ndërsa për shumë produkte të konsumit familjar çmimet gati janë dyfishuar. Kur çmimet dyfishohen, jeta e qytetarëve bëhet më e vështirë. Propaganda për sukses ekonomik nuk e mbush shportën e konsumit të familjeve! Qeveria mund të prezantojë shifra miliardëshe, por realiteti matet me koston e konsumit familjar, matet me koston që çdo vikend familja paguan në arkën e marketeve. Debati që duhet të bëhet në Kuvend me rastin e diskutimit të buxhetit 2027-2029 duhet të përqendrohet në këto çështje: -



Çfarë ka ndodhur me koston e jetës së qytetarëve? - Kush mban përgjegjësi për këtë dhe - Çfarë mund të bëhet për të lehtësuar këtë barrë?", ka shkruar Hoti.

BQK-ja PARAQET PARA STUDENTËVE TË UP-së REFORMAT NË SISTEMIN E PAGESAVE: SEPA DHE TIPS CLONE

Prishtinë, 10 nëntor - Zëvendësguvernatori për Operacione Bankare i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Dardan Fusha, ka mbajtur një ligjëratë të ftuar për studentët e Universitetit të Prishtinës, ku ka paraqitur zhvillimet dhe reformat në modernizimin e sistemit të pagesave në Kosovë.


Ligjërata u mbajt në kuadër të lëndës Menaxhment i Avancuar Bankar, të profesoreshës Albulena Shala, me temën "Modernizimi i Sistemit të Pagesave në Kosovë: SEPA dhe TIPS Clone".

Gjatë ligjëratës Fusha ka shpjeguar rëndësinë e përfshirjes së Kosovës në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), e cila mundëson realizimin e pagesave ndërkufitare në euro sipas rregullave dhe standardeve të përbashkëta evropiane. Ai ka diskutuar edhe për hapat që pasojnë dorëzimin e aplikimit të Kosovës, duke theksuar se përfshirja në hapësirën gjeografike të SEPA-s dhe gatishmëria operacionale e ofruesve të shërbimeve të pagesave janë procese të ndërlidhura, por të veçanta.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimit iu kushtua edhe projektit TIPS Clone dhe përgatitjeve për lansimin e sistemit të pagesave të shpejta në Kosovë. Ky sistem synon ta mundësojë realizimin e pagesave brenda pak sekondave, 24 orë në ditë dhe gjatë gjithë vitit.

Studentët u njohën gjithashtu me rëndësinë e menaxhimit të likuiditetit, sigurisë kibernetike, parandalimit të mashtrimeve dhe qëndrueshmërisë operacionale, si dhe me shërbimet e reja të planifikuara, përfshirë pagesat përmes kodeve QR, identifikuesit alternativë, kërkesat për pagesë dhe verifikimin e përfituesit.

Gjatë ligjëratës u trajtuan edhe zhvillimet në fushën e euros digjitale, depozitave dhe aseteve të tokenizuara, stablecoin-ëve dhe teknologjive të reja financiare, duke u theksuar rëndësia që inovacioni ta ruajë besimin në para dhe të sjellë përfitime konkrete për përdoruesit. "Njohja me këto zhvillime është me rëndësi për



profesionistët e ardhshëm të sektorit financiar. Synimi ynë është që modernizimi i pagesave të përkthehet në shërbime më të shpejta, më të sigurta dhe më të qasshme për qytetarët dhe bizneset", ka theksuar Fusha.

Në fund, BQK-ja ka vlerësuar bashkëpunimin me Universitetin e Prishtinës, duke theksuar rëndësinë e krijimit të mundësive që studentët të njihen nga afër me reformat dhe zhvillimet e fundit në sektorin financiar të Kosovës.

"BUXHET I MBIJETESËS", GËRXHALIU: KOSOVA, SHTET I VARUR NGA IMPORTI DHE NDIHMAT SOCIALE



Prishtinë, 10 nëntor - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, e ka quajtur buxhet të mbijetesës, buxhetin për vitin e ardhshëm. Në emisionin "Ora Shtatë" në "Klan Kosova", eksperti i ekonomisë ka thënë se rritja e buxhetit nuk është reale pasi, sipas tij, shifrat kanë ndryshuar për shkak të rritjes së inflacionit. "Kosova të mos krekoset me numra, por me substancë, por pyetja duhet të jetë se sa do të dimë të shfrytëzojmë, sa do të arrijmë ta kthejmë në investime dhe zhvillim ekonomik. Është buxhet i mbijetesës", ka thënë Gërxhaliu.

Ai ka marrë si shembull edhe buxhetin për këtë vit ku ishin paraparë afër një miliard euro për projekte kapitale, mirëpo vetëm 30 % prej tyre janë shpenzuar. "Sektori privat po ngulfatet dhe krijimi i vendeve të reja të punës do të jetë shumë më i vogël. Do të jetë vështirë për të mbijetuar në këto rrethana", ka thënë ai.

Gjithashtu, Gërxhaliu ka kritikuar për varësinë nga importi dhe fokusin e institucioneve te ndihmat sociale. "E keqja që po i ndodh Kosovës është se jemi shndërruar në një shtet të varur nga importi. Në rend të dytë jemi shndërruar në një shtet që jetojmë nga ndihmat sociale dhe ajo nuk është zgjidhje. Dhe, e treta, sektori privat përkundër kontributit që ka dhënë dhe është duke dhënë duhet të jetë më tepër i orientuar në ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë së Kosovës. Ka të bëjë me menaxhim, me standardizim dhe me certifikim. Kohën e fundit kemi skandale të shumta sa i përket prodhimit", ka shtuar ish-kreu i OEK-ut.

Kuvendi Komunal i Rahovecit miraton harmonizimin e mjeteve buxhetore për vitin 2026

Rahovec, 10 nëntor - Është mbajtur të martën seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e thirrur nga kryetari i komunës, Smajl Latifi, me kërkesë të nivelit qendror, përkatësisht Departamentit për Buxhet. Në këtë seancë, anëtarët e Kuvendit Komunal kanë shqyrtuar propozim-vendimin për harmonizimin e mjeteve nga kategoria e pagave, në kuadër të programeve buxhetore për vitin 2026. Pas shqyrtimit, propozim-vendimi është miratuar me 18 vota për, ndërsa katër anëtarë kanë abstenuar. Me këtë vendim, Kuvendi Komunal i Rahovecit ka miratuar harmonizimin e mjeteve buxhetore nga kategoria e pagave, sipas kërkesës së nivelit qendror.



PARA, SEKS DHE SPIUNAZH: RËNIA E MBRETIT TË NVIDIA-S TRONDIT GJITHË INDUSTRINË E TEKNOLOGJISË SË LARTË

Titujt Nvidia-s, gjigantit të themeluar nga Huang pësojnë rënie në Wall Street.

Skandali që tronditi botën e Nvidia-s



Në mbrëmjen e 3 nëntorit, ndërsa në Shtetet e Bashkuara po shtoheshin votat kundër Donald Trump-it, shumë prej emrave më të mëdhenj të industrisë së teknologjisë së lartë ishin mbledhur në Operën e San Franciskos.
Në skenë po shfaqej opera Dasma e Figaros, pikërisht "dita e çmendur" gjatë së cilës Konti Almaviva përpiqet të joshë shërbëtoren Susanna.
Në sallë, pranë bashkëshortes së tij të ligjshme, Lori, ndodhej edhe njeriu që i kishte ftuar të gjithë: Jensen Huang, themeluesi dhe drejtori ekzekutiv i Nvidia-s, gjigantit të prodhimit të çipave, vlera e të cilit në Wall Street kishte arritur sa dyfishi i Prodhimit të Brendshëm Bruto të Italisë.
Vetëm pak ditë më vonë, Kontit të ri Almaviva do t'i duhej të pranonte se Susanna e tij nuk ishte aspak një grua naive.
Alice Huang, me të cilën ai nuk kishte asnjë lidhje farefisnore, ishte zyrtarisht drejtuese e kompanisë Megaspeed, një shoqëri me qendra të përpunimit të të dhënave në Singapor dhe kliente e Nvidia-s.
Jozyrtarisht, ajo ishte një mikeshë që përfitonte nga marrëdhënia me Huang-un tjetër. Por, në të vërtetë, sipas shërbimeve amerikane të inteligjencës, ajo ishte një agjente e rekrutuar nga Pekini.
Kështu, të dielën, pas raportimeve të para në shtyp, drejtuesi i fuqishëm i Nvidia-s u detyrua t'u shkruante punonjësve të kompanisë, duke kërkuar falje edhe ndaj bashkëshortes së tij, me të cilën është martuar në vitin 1985.
Bordi drejtues nisi një hetim, ndërsa aksionet e kompanisë shënuan një rënie prej më shumë se 5% gjatë ditës së djeshme.

Dyshimet për spiunazh dhe rreziku për sigurinë amerikane

A do të përfundojë gjithçka me kaq? Nëse Nvidia pa drejtuesin e saj historik është e paimagjinueshme, serioziteti i situatës lë të hapur çdo skenar.
Shqetësimi kryesor lidhet me rrezikun që kinezët mund të kenë siguruar informacione ose akses te çipat që qeveria amerikane i konsideron si më strategjikët për vendin.
Ajo që e bën edhe më të mprehtë përzierjen e zakonshme të seksit, parave dhe spiunazhit është fakti se, krahas Huang-ut, për herë të dytë brenda pak ditësh po tronditet edhe një botë shumë më e gjerë: ajo e gjigantëve të teknologjisë dhe e inteligjencës artificiale.

Nvidia, shtylla kryesore e revolucionit të inteligjencës artificiale

Nuk bëhet fjalë vetëm për peshën e jashtëzakonshme të një kompanie që u bë e para në botë që kapërceu vlerën e 5 500 miliardë dollarëve në kapitalizimin e tregut.
Çështja lidhet edhe me rolin që Nvidia dhe vetë Huang-u luajnë në një ekosistem teknologjik, ku kompania, e krijuar në vitet '90 për prodhimin e procesorëve të kartave grafike të videolojërave, është shndërruar në shtyllën kryesore mbi të cilën mbështetet e gjithë industria e inteligjencës artificiale.
Sot, Nvidia nuk është thjesht një furnizuese çipash, por edhe një nga financueset më të mëdha të kësaj fushe të re teknologjike.
Pas kësaj makinerie gjigante qëndron një njeri që pretendon se nuk ka "asnjë hobi".

Nga Tajvani në Amerikë: Fëmijëria dhe rruga e vështirë drejt suksesit

Jensen Huang lindi në Tajvan në vitin 1963. Kur ishte nëntë vjeç, prindërit e dërguan në Shtetet e Bashkuara bashkë me vëllanë e madh, pa asnjë të rritur që t'i shoqëronte.
Një xhaxha i regjistroi në atë që ai mendonte se ishte një kolegj prestigjioz në Kentaki. Në të vërtetë, bëhej fjalë për një institucion për të rinj me probleme të sjelljes.
Që në mbrëmjen e parë, shoku i tij i dhomës, një 17-vjeçar analfabet, i tregoi plagët e lëna nga goditjet me thikë.
Më pas nisi versioni aziatik i ëndrrës amerikane: pingpongu në nivel kombëtar, turnet si larës pjatash në restorantet Denny's dhe diploma në inxhinieri elektrike në Universitetin Shtetëror të Oregonit.

Themelimi i Nvidia-s dhe zbulimi që ndryshoi historinë e teknologjisë

Në fund të viteve '90, pasi kishte themeluar Nvidia-n në vitin 1993 së bashku me dy ortakë, Huang vuri re se gjithnjë e më shumë zhvillues po i përdornin çipat e kompanisë së tij, të krijuar fillimisht për kartat grafike, edhe për qëllime të tjera, veçanërisht për përllogaritje shumë komplekse.
Çelësi që i hapi rrugën drejt kësaj bote ishte CUDA, një program kompjuterik i zhvilluar brenda kompanisë, i cili i shndërronte kartat grafike në mjete për përllogaritje me fuqi të jashtëzakonshme.
Më pas, në vitin 2012, ndodhi kthesa vendimtare. Dy studiues nga Toronto trajnuan një rrjet nervor, pararendës të sistemeve të sotme të inteligjencës artificiale, duke përdorur dy karta grafike Nvidia. Ky rrjet ishte në gjendje të njihte disa imazhe.
Një të premte në mbrëmje, Huang njoftoi me një email se Nvidia nuk ishte më një kompani e kartave grafike dhe se, duke nisur nga e hëna, do të ishte një kompani e inteligjencës artificiale.

Stili i ashpër i drejtimit: Disiplina, dhimbja dhe vuajtja

Shpejtësia e këtij transformimi lidhet edhe me karakterin e fortë dhe vendosmërinë e themeluesit.
Metoda e drejtimit të Huang-ut është njëkohësisht e njohur dhe e frikshme.
Rreth 50 drejtues raportojnë drejtpërdrejt tek ai, ndërsa kritikat dhe qortimet publike konsiderohen si pjesë e procesit të të mësuarit kolektiv. Në fund të fundit, kur e pyesin për sekretin e suksesit, Huang rekomandon si domosdoshmëri "doza të bollshme dhimbjeje dhe vuajtjeje".

Perandoria financiare e Nvidia-s: Nga furnizues çipash në financues të industrisë

Rëndësia e Nvidia-s tashmë qëndron në rolin gjithnjë e më të shumëanshëm që kompania ka marrë gjatë viteve të fundit.
Ajo është njëkohësisht furnizuese, kreditore dhe financuese e një pjese të madhe të botës së teknologjisë.
Ky ndikim shtrihet nga gjigantët e infrastrukturës cloud, si Meta dhe Google, deri te kompanitë e reja të shërbimeve cloud, si CoreWeave, ku Nvidia zotëron aksione.
Huang ka investuar 30 miliardë dollarë në OpenAI, 20 miliardë për blerjen e Groq dhe 13 miliardë për marrjen e Hugging Face.
Në bashkëpunim me elitën e botës financiare, nga KKR te Goldman Sachs, ai ka krijuar një platformë për financimin e qendrave të përpunimit të të dhënave, me një vlerë prej 500 miliardë dollarësh, të pajisura me çipat e kompanisë së tij.
I gjithë ky sistem mbështetet në shifra marramendëse.
Qarkullimi më i fundit i Nvidia-s ka arritur në 215,9 miliardë dollarë, me një marzh bruto fitimi prej 75%.

Jensen Huang, më pak i dukshëm se Elon Musk, por ndoshta më i rëndësishëm

Huang është më pak i pranishëm në sytë e publikut sesa Elon Musk, por ndoshta ka një rol edhe më thelbësor në sistemin teknologjik.
Ndryshe nga pronari i Tesla-s, ai thotë se përpiqet të qëndrojë "sa më larg fantashkencës".
Megjithatë, edhe ai është shndërruar në një njeri me pushtet të jashtëzakonshëm.
Ditën kur mbushi 62 vjeç, mori një telefonatë nga Donald Trump. Fillimisht mendoi se ishte një shaka, por biseda zgjati plot 45 minuta.

Diplomacia e çipave: Marrëdhëniet me Trump-in, Kinën dhe Lindjen e Mesme

Më pas erdhën furnizimet për Arabinë Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, si edhe marrëveshja që i garantonte Uashingtonit 25% të të ardhurave nga shitjet në Kinë të një çipi më pak të fuqishëm se modeli më i avancuar, në këmbim të licencave të eksportit.
Megjithatë, diplomacia e Huang-ut mes dy brigjeve të Paqësorit nuk ka qenë gjithmonë e suksesshme.
Përpjekja për të eksportuar në Pekin çipat më të avancuar u bllokua nga Uashingtoni. Tani Trump del në mbrojtje të tij, duke e cilësuar si "një njeri të nderuar".

Pika e dobët e perandorisë: Varësia nga një njeri i vetëm

Por çështja, me të gjitha hijet e dyshimeve që lidhen me Kinën, nuk është më thjesht private.
Një sistem i tërë, i mbështetur te bilancet financiare, garancitë dhe besueshmëria e një njeriu të vetëm, po zbulon se pika e tij më e dobët është pikërisht ai njeri. / bota.al

ÇFARË QËNDRON PAS REBELIMIT AMERIKAN KUNDËR MUSK DHE GJIGANTËVE TË TEKNOLOGJISË?



Amerikanët po shfaqin gjithnjë e më shumë pakënaqësi ndaj gjigantëve të teknologjisë dhe zhvillimit të shpejtë të inteligjencës artificiale. Kundërshtimet lidhen me konsumin e madh të energjisë elektrike dhe ujit nga qendrat e të dhënave, zgjerimin e sistemeve të mbikëqyrjes elektronike dhe pasurimin e jashtëzakonshëm të drejtuesve të kompanive të mëdha teknologjike.

Në shënjestër të kritikave është edhe presidenti i SHBA-ve Donald Trump, i cili akuzohet se nuk po vendos masa mbrojtëse për qytetarët përballë fuqisë në rritje të këtyre kompanive.

Pak më shumë se 20 vjet më parë, interneti dhe teknologjia shiheshin si premtimi i një bote të re, ku informacioni dhe shërbimet do të ishin të aksesueshme për të gjithë. Themeluesit e Google, Larry Page dhe Sergey Brin, premtonin ta bënin dijen universale të arritshme me një klikim, ndërsa Mark Zuckerberg e paraqiste Facebook-un si një platformë që do ta bënte botën më të hapur dhe të lidhur.

Në atë periudhë, shumë besonin se po realizohej vizioni i John Perry Barloë, një prej figurave të para të lirisë digjitale. Në vitin 1996, ai kishte shpallur pavarësinë e hapësirës kibernetike nga qeveritë tradicionale, duke e përfytyruar internetin si një hapësirë të lirë, larg kontrollit politik dhe ekonomik.

Edhe Elon Musk shihej si një prej figurave që do të ndryshonin të ardhmen, përmes projekteve të tij në industrinë e automjeteve dhe eksplorimin e hapësirës. Por imazhi i sipërmarrësve të teknologjisë si njerëz që punonin për të mirën e njerëzimit ka ndryshuar ndjeshëm.

Sot, drejtuesit e kompanive të mëdha teknologjike përballen me kritika dhe protesta. Në universitete, disa prej tyre janë pritur me kundërshtime, ndërsa në Hollyëood po prodhohen gjithnjë e më shumë filma dhe dokumentarë që kritikojnë ndikimin e tyre në shoqëri. Në shumë komunitete amerikane, kundërshtimi ndaj ndërtimit të qendrave të të dhënave dhe kostove që ato sjellin është kthyer edhe në një faktor politik, duke ndikuar në humbjet e republikanëve në zgjedhjet e fundit.

Një prej humbjeve më të dukshme ishte ajo e Elon Musk në Teksas. Pasi u zhvendos nga Kalifornia në këtë shtet, duke kërkuar një mjedis me më pak taksa dhe rregulla, Musk shpenzoi më shumë se 200 milionë dollarë për të mbështetur kandidatët konservatorë në zgjedhjet lokale. Megjithatë, demokratët progresistë arritën të fitonin kontrollin e institucioneve kryesore të shtetit, përfshirë postin e guvernatorit, senatin dhe parlamentin.

Pakënaqësia ndaj kompanive të teknologjisë nuk është e re. Prej rreth një dekade, është shtuar kritika ndaj modelit të biznesit të platformave digjitale dhe pasurisë së jashtëzakonshme të krijuar nga drejtuesit e tyre. Një nga shqetësimet kryesore lidhet me faktin se shërbimet që ofrohen falas shpesh mbështeten te mbledhja dhe përdorimi i të dhënave personale të përdoruesve.

Gjithashtu, rrjetet sociale janë kritikuar për ndikimin e tyre në edukimin dhe shëndetin psikologjik, nxitjen e trazirave, përhapjen e urrejtjes dhe ndërhyrjet në proceset zgjedhore. Në disa raste, platformat janë lidhur edhe me përhapjen e propagandës që ka nxitur dhunë dhe spastrime etnike, si në rastin e komunitetit Rohingya në Birmani.


Megjithatë, zhvillimi i inteligjencës artificiale po ndryshon edhe më thellë marrëdhënien e njerëzve me teknologjinë. Që prej daljes së ChatGPT, katër vite më parë, kjo teknologji është përhapur me shpejtësi në jetën e përditshme, duke ngritur shqetësime për të ardhmen e vendeve të punës, privatësinë dhe ndikimin e saj në shoqëri.

Një tjetër burim pakënaqësie janë qendrat e të dhënave, të cilat kërkojnë sasi shumë të mëdha energjie elektrike dhe uji. Banorët e zonave ku ndërtohen këto objekte kundërshtojnë kostot dhe barrën që ato mund t'u sjellin komuniteteve lokale, ndërsa përfitimet ekonomike nuk janë gjithmonë të barabarta për të gjithë.

Edhe brenda industrisë së inteligjencës artificiale ka debate për ritmin e zhvillimit. Një pjesë e drejtuesve dhe studiuesve mbështesin përparimin sa më të shpejtë drejt krijimit të sistemeve gjithnjë e më të fuqishme, ndërsa të tjerë kërkojnë më shumë kujdes dhe kufizime për të parandaluar rreziqet e mundshme. Megjithatë, të dyja palët pranojnë se zhvillimi i kësaj teknologjie do të vazhdojë, pavarësisht pasigurive dhe rreziqeve që mund të sjellë.

Në zgjedhjet e fundit, votuesit amerikanë kanë dhënë sinjale se nuk janë më të gatshëm t'u japin kompanive të mëdha teknologjike liri të pakufizuar. Kundërshtimi ndaj qendrave të të dhënave, kostove të tyre dhe mungesës së kontrollit mbi inteligjencën artificiale është kthyer në një çështje që ndikon edhe në vendimmarrjen politike. Megjithatë, frenimi i këtij zhvillimi nuk do të jetë i lehtë. Shtetet e Bashkuara janë nën presionin e konkurrencës me Kinën, ndërsa një pjesë e madhe e rritjes ekonomike amerikane lidhet tashmë me investimet në inteligjencën artificiale. Edhe demokratët, të cilët gjatë fushatës zgjedhore kanë kërkuar më shumë kontroll mbi këtë sektor, mund të ndahen kur të duhet të vendosin me ligj se deri ku duhet të shkojnë kufizimet.

Investimet në inteligjencën artificiale kanë arritur përmasa të jashtëzakonshme, duke përfshirë shuma prej triliona dollarësh. Kjo ngre shqetësimin se kompanitë e mëdha të sektorit mund të bëhen aq të fuqishme sa të mos lejohet falimentimi i tyre, njësoj si bankat dhe kompanitë e sigurimeve që u shpëtuan nga shteti amerikan pas krizës financiare të vitit 2008 dhe kolapsit të Lehman Brothers. Një skenar i tillë do të kishte pasoja të mëdha për taksapaguesit dhe sistemin politik amerikan. Prandaj, pakënaqësia e votuesve shihet si një paralajmërim për gjigantët e teknologjisë: pas vitesh investimesh dhe zgjerimi të pakontrolluar, shoqëria po kërkon më shumë transparencë, përgjegjësi dhe mbrojtje për qytetarët.



sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Xhaka, lojtari më i mirë me numrin 34 në fanellë



Sunderland, 10 nëntor - Mesfushori i Sunderlandit, Granit Xhaka, është përzgjedhur futbollisti më i mirë që ka bartur fanellën me numrin 34. "Guardian" e ka përzgjedhur kapitenin e Zvicrës dhe të Sunderlandit si futbollistin më të mirë që ka bartur fanellën me numrin 34, në një renditje që përfshin lojtarët më të dalluar sipas numrave të fanellave. Në këtë përzgjedhje Xhaka është renditur para emrave të njohur të futbollit, përfshirë holandezin Nigel de Jong, i cili, po ashtu, ka luajtur me numrin 34 gjatë karrierës së tij. Numri 34 ka një domethënie të veçantë për Xhakën. Ai e kishte zgjedhur në kohën kur ishte pjesë e akademisë së Baselit, pasi autobusi me të cilin udhëtonte drejt stërvitjeve mbante pikërisht këtë numër. Që nga ajo kohë Xhaka e ka ruajtur numrin 34 në skuadrat ku ka luajtur: Basel, Borussia Mönchengladbach, Arsenal dhe Bayer Leverkusen. 34-vjeçari është shumë i rëndësishëm për Sunderlandin dhe për Zvicrën, kurse aktualisht është i lënduar.

PRESIDENTJA SHIROKA-PULA FALËNDERON "DARDANËT" PËR PËRFAQËSIMIN DINJITOZ TË KOSOVËS NË ARENËN NDËRKOMBËTARE







Prishtinë, 10 nëntor - Kombëtarja e Kosovës ka pasur një mysafire të veçantë në kampin e grumbullimit në hotel "Emerald", ku është pritur ngrohtësisht presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula. Ajo është pritur nga presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, përzgjedhësi Franco Foda, futbollistët dhe stafi i Kombëtares. Me këtë rast, presidenti i FFK-së e ka uruar Shiroka Pulën për marrjen e detyrës së presidentes së Republikës, duke i dëshiruar suksese në udhëheqjen e vendit dhe në realizimin e projekteve shtetërore.

Nga ana e saj, presidentja Shiroka-Pula ka shprehur kënaqësinë për vizitën dhe takimin me Dardanët, duke i falënderuar për përfaqësimin dinjitoz të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ajo i ka vlerësuar futbollistët si ambasadorët më të mirë të vendit, duke theksuar se me talentin, përkushtimin dhe sukseset e tyre kanë arritur ta vendosin emrin e Kosovës aty ku ndonjëherë politika nuk ka mundësi.

Presidentja Shiroka-Pula u ka uruar futbollistëve suksese në dy ndeshjet e ardhshme, kundër Izraelit në stadiumin "Fadil Vokrri" dhe Irlandës në udhëtim, si dhe ka përshëndetur në mënyrë të veçantë tre futbollistët që për herë të parë janë ftuar në Kombëtare.

Ndërsa presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka falënderuar presidenten për vlerësimin që ua ka bërë futbollistëve të Kombëtares së Kosovës, të cilët me talentin, përkushtimin dhe paraqitjet e tyre janë ambasadorët më të mirë të Kosovës në botë.

"Besoj se bashkëpunimi dhe mbështetja institucionale janë thelbësore për të ardhmen e futbollit tonë. Faleminderit për vizitën dhe përkrahjen, presidente Shiroka-Pula!", është shprehur Ademi.

"DARDANËT" VAZHDOJNË ME STËRVITJE, MUNGON DELLOVA




Prishtinë, 10 nëntor - Futbollistët e Kombëtares së Kosovës kanë vazhduar me stërvitje të martën paradite, në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen me Izraelin. Edhe stërvitja e dytë, sikurse ajo e së hënës mbrëma, është mbajtur në kampin nacional të FFK-së, në Hajvali. Megjithatë, në stërvitjen e dytë, selektori Franco Foda e kishte të gjithë ekipin në fushë, ndryshe nga e hëna, kur ishin të pranishëm vetëm 15 futbollistë, pasi të tjerët ishin lënë në regjenerim pas angazhimeve me klubet e tyre. Në stërvitjen e së martës mungoi Lumbardh Dellova, kurse i pranishëm ishte edhe Betim Fazliji, që i është bashkuar grumbullimit pas mungesave tashmë të konfirmuara për duelet e nëntorit. Atmosfera brenda ekipit ishte e mirë, ndërsa selektori Foda ka pasur mundësi të mbajë seancë stërvitore me intensitet të lartë, duke pasur parasysh disponimin e futbollistëve. Kosova të shtunën, prej orës 15:00, përballet me Izraelin në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, kurse tri ditë më vonë do të luajë në udhëtim kundër Irlandës.

KURTI: FRANCA, PARTNERE E RËNDËSISHME PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE MESDHETARE



Paris, 10 nëntor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Franca është partnere e rëndësishme për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030". Ai kështu është shprehur pas takimit që ka zhvilluar me ambasadorin francez për Sportin, Damien Combredet-Blassel, ambasadorin e Francës në Kosovë, Jean-François Huchet, si dhe personalitete kyçe në organizimin e Lojërave Olimpike "Paris 2024", përfaqësues të "France Sport Expertise". Kurti ka thënë se në këtë takim kanë marrë kështilla për veprimet që duhet të ndërmerren dhe ato që kanë përparësi. "Me marrëveshjen e kredisë me AFD-në për investime infrastrukturore në kuadër të përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare dhe Deklaratën e Synimit për themelimin e Komitetit të përbashkët për këto lojëra, të nënshkruara në fund të muajit korrik, Franca është partnere e rëndësishme për organizimin e 'Prishtina 2030'", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Zhegrova pritet të largohet në janar nga Juventusi



Torino, 10 nëntor - Disa lojtarë, në mesin e të cilëve është edhe Edon Zhegrova, pritet të largohen nga skuadra e Juventusit në afatin kalimtar të dimrit.

Mediet italiane kanë bërë me dije se trajneri Luciano Spalletti tashmë ka identifikuar lojtarët që do të largohen nga ekipi. Sa i përket Zhegrovës është thënë se Spalletti nuk është i bindur nga sulmuesi i krahut, të cilit ende nuk i ka besuar një vend titullari në asnjë ndeshje kampionale. Spalletti e ka kritikuar vazhdimisht Zhegrovën për mungesën e qëndrueshmërisë dhe përqendrimit në fushë dhe, për këtë arsye, nuk llogarit në shërbimet e tij. Po ashtu, thuhet se edhe Zhegrova nuk është i kënaqur me rolin e rezervistit te Juventusi dhe mund t'i shqyrtojë opsionet për t'u larguar në janar. Në nëntë ndeshje të luajtura në Serinë A këtë sezon, Zhegrova ka dy gola e po aq asistime, kurse me Juventusin ka kontratë deri në vitin 2030.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Kualiteti-Plast'' Sh.p.k. Qerim-Gjakovë për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/1779MMPH, për Fabrikën për riciklimin e mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Qerim, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 01.12.2026, në ora: 10:00 h, në hapësirat e kompanisë "Kualiteti Plast" Sh.p.k., në fshatin Qerim K. Gjakovë do të organizohet debat publik nga operatori "Kualiteti-Plast'' Sh.p.k. Qerim-Gjakovë, për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/1779MMPH, për Fabrikën për riciklimin e mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Qerim, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID: 978 061 9194

Passcode: LsKi3H

https://us05web.zoom.us/j/9780619194?pwd=utLa9j36e3WHTyhKaJw72N2IbG2oQ9.1

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

_____

Kualiteti-Plast Sh.p.k. Qrim, K. Gjakovë

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Femme Underwear SH.P.K." SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811436155 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Femme Underwear" D.O.O. sa sjedištem u Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811436155 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Femme Underwear" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811436155 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Queens Cosmetics" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810013178 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Queens Cosmetics" D.O.O. sa sjedištem u Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810013178 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Queens Cosmetics" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810013178 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES